

**Nebi CAKA**

## **TERMINOLOGJIA E INFORMATIKËS NË GJUHËN SHQIPE DHE STANDARDIZIMI I SAJ NË FJALORË**

Terminologjia e informatikës është duke fituar rëndësi gjithnjë më të madhe në të gjitha gjuhët, për shkak të rritjes gjithnjë e më të madhe të numrit të përdoruesve të kompjuterëve personalë dhe të internetit në të gjitha shtetet e të gjitha kategoritë e popullatës.

*Kompjuteri e printeri, disketa e kompaktdisku, Interneti e uebi (mbarëbotëror) janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë, po aq sa telefoni e televizori. Informatizimi apo kompjuterizimi ka përfshirë të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore. Kështu, kemi: aparaturë kompjuterike, central kompjuterik, disketë kompjuterike, dosje kompjuterike, ekran kompjuterik, fotografi kompjuterike, lidhje kompjuterike, mjet kompjuterik, pajisje kompjuterike, rrjet kompjuterik, sistem kompjuterik, terminal kompjuterik etj.*

Për të përshkruar aftësinë për të përdorur kompjuterin, përdoren togfjalëshat, si: *aftësi kompjuterike, dije kompjuterike, kulturë kompjuterike, njohuri kompjuterike, përvojë kompjuterike, shkathtësi kompjuterike etj.*

Kjo arrihet nëpërmjet: *kurseve kompjuterike, që organizohen në laboratorë, qendra e salla kompjuterike në fakultetet e shkencave kompjuterike, në degën a departamentin e inxhinierisë kompjuterike a të fizikës kompjuterike, – dhe të gjitha këto i mundëson teknologjia kompjuterike e industria kompjuterike.*

Sot librat *përgatiten, radhiten, përpunohen e shtypen në mënyrë kompjuterike. Kompjuterike mund të jenë jo vetëm lojërat, po edhe pirateria e krimi, si edhe etika, e madje edhe jeta e bota<sup>1</sup>.*

Numri i termave të krijuar për të shprehur konceptet e reja që kanë të bëjnë me informatikën dhe me teknologjinë e informacionit vazhdimisht rritet, meqë vazhdimisht rritet numri i pajisjeve të reja të teknologjisë së informacionit dhe i programeve kompjuterike. Këto

---

<sup>1</sup> Shembujt e mësipërm janë marrë nga shtypi dhe interneti.

pajisje e këto programe kryesisht vijnë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e bashkë me to dokumentacioni përcjellës me termat përkatës në gjuhën angleze.

Si rrjedhojë, vendet joanglishtfolëse ballafaqohen me çështjen e përkthimit, në gjuhë vendi, të dokumentacionit dhe të termave që i shoqërojnë këto pajisje dhe këto programe, shpesh menjëherë pas hedhjes së tyre në treg. Kjo kërkon nga përkthyesit dhe nga terminologët e këtyre vendeve analizimin e termit burimor dhe gjetjen e barasvlerësit të saktë në gjuhën e tyre.

Sasia dhe shpejtësi e madhe e depërtimit të këtyre termave nga anglishtja në gjuhët e tjera e vështirëson krijimin me sukses të një terminologjie të njëzuar të informatikës në shumicën e gjuhëve. Për shkak të pamundësisë së reagimit të shpejtë dhe me sukses, shpesh përqafohet termi i anglishtes, madje pa përshtatjen e nevojshme fonetike, morfologjike e semantike. Anglishtja, falë globalizimit dhe internetit, po merr rolin e gjuhës ndërkombëtare, të ashtuquajturës gjuhë botërore. Kështu edhe *kompjuter*, edhe *harduer* e *softuer*, edhe *internet* e *ueb* po bëhen fjalë ndërkombëtare.

Mungesa e një terminologjie të njëzuar pa mëdyshje e vështirëson përdorimin e efektshëm të pajisjeve dhe të programeve kompjuterike nga ana e joprofesionistëve, po edhe nga ana e vet profesionistëve. Së këtejmi del edhe nevoja e ngutshme për standardizimin e terminologjisë së informatikës, së paku të asaj pjese që tashmë ka hyrë në përdorim të gjerë, jo vetëm profesional, por edhe të përgjithshëm.

Standardizimi i terminologjisë, në përgjithësi, ka për objektiv njësimin dhe harmonizimin e koncepteve, të sistemeve të koncepteve, të termave dhe të përkufizimeve. Kjo siguron një fjalor normativ në të cilin vetëm një term i korrespondon një koncepti dhe vetëm një koncept i korrespondon një termi.<sup>2</sup>

Dykuptimësia, apo madje dhe shumëkuptimësia e termave, e shkaktuar nga polisemia, sinonimia ose homonimia, krijon vështirësi në të kuptuarit e përpiktë të domethënies së tyre në komunikimin ndërmjet njerëzve, në përgjithësi, e madje edhe ndërmjet vetë

<sup>2</sup> ISO 10241, *International terminology standards – Preparation and layout*

specialistëve të një fushe<sup>3</sup>. Termat duhet të jenë të njëkuptimshëm. Parimi i njëkuptimësisë është një ndër parimet themelore të terminologjisë.

Terminologjia e standardizuar, si rezultat i procesit të standardizimit të terminologjisë, përmirëson komunikimin ndërmjet njerëzve dhe njëherazi u mundëson atyre t'i qasen më lehtë dhe më mirë informacionit dhe ta përdorin atë më mirë.<sup>4</sup>

Një prej detyrave me rëndësi, por të vështira, që kanë të bëjnë me standardizimin, është futja në përdorim e termave të mirëpërcaktuar dhe të mirëpërkufizuar, të cilët do të përdroreshin në mënyrë konsekuente në të gjitha dokumentet e në të gjitha tekstet shkollore, profesionale e shkencore të një vendi.

Në fjalorët terminologjikë të informatikës në gjuhë të ndryshme, përveç termave të mirëfilltë të informatikës, përfshihen edhe një numër i madh i termave nga fusha të tjera, si: akustikë, elektronikë, elektroteknikë, fizikë, gjuhësi, logjikë, matematikë, optikë, telekomunikacion etj., për arsye se ata shpesh hasen në literaturën nga fusha e informatikës.

Fjalorët e këtillë në të shumtën e rasteve vetëm i regjistrojnë dhe i përshkruajnë fjalët që përdoren në fushën e informatikës dhe në fushat me të cilat shërbehet ajo. Në këta fjalorë për shumë fjalë ofrohen variante të të njëjtut përkthim të termit burimor (kryesisht në anglisht) dhe përkthimi i parë përdoret më tutje në fjalor në të gjitha vendet ku në tekst shfaqet termi përkatës në kuadër të termave të tjerë.

Nga ana tjetër, në shumë fjalorë terminologjikë të fushave të tjera të dijes, e po ashtu edhe në fjalorë të përgjithshëm njëgjuhësh e dygjuhësh, shfaqen edhe terma nga informatika. Një fjalor i tillë është "*Fjalori anglisht–shqip i radioelektronikës*" i Arif B. Tomçinit, botuar nga Toena, Tiranë, 2004. Siç thotë autori, "ky botim [me 23000 fjalë terma e shprehje], pas atij të vitit 1979 me 15000 fjalë, i përmirësuar e i pasuruar, ka një vend të gjerë edhe për informatikën, këtë teknikë të re që vitet e fundit ka njohur një hov të shpejtë me zhvillimin e mikroordinatorëve (ose mikroprocesorëve)...".

<sup>3</sup> Kjo vlen për të gjitha fushat; shih *Parathënien e Fjalorit të termave themelore të mekanikës*, Tiranë, 2002.

<sup>4</sup> ISO 10 87-1, *Terminology work – Vocabulary Part 1 Theory and application*

*Informatika* në këtë fjalor përfaqësohet me dy nënfusha: “kompjuterët, ordinatorët” (ord.) dhe “teknika llogaritëse elektronike” (tek. llog.).

Edhe pse, sipas autorit, 75% e termave në anglishte janë dhënë me barasvlerësit e tyre në shqip, ndërsa pjesa tjetër, prej 25%, është dhënë me parafrazime, – si p.sh., për termin *clock* të informatikës (tek. llog) jepet: *burim kryesor i sinjaleve të sinkronizimit në ordinatorët elektronikë*, apo për termin *laptop* (ord.) jepet: *lloj kompjuteri me përmasa të vogla* – shihet se autori i fjalorit nuk ka synim normëzimin e termave, por, në radhë të parë, përkthimin dhe shpjegimin e tyre. Sa kohë që nuk ka fjalorë shpjegues, është e arsyeshme, mbase, që aty–këtu të jepen edhe shpjegime a informacione shtesë, me qëllim të sqarimit të termave të ndryshëm, sidomos të atyre më pak të njohur, ose të krijuar rishtas. Megjithatë, në fjalorët terminologjikë dygjuhësh e disagjuhësh do të duhej të jepeshin barasvlerësit shqip të termit në gjuhë të huaj, nëse jo me karakter normëzues – standardizues, siç është vepruar në fjalorët terminologjikë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë<sup>5</sup>, atëherë, së paku, me sugjerim të hierarkisë së rekomanduar apo të parapëlqyer të përdorimit të termave. Kështu, b.f., për termin **computer** të anglishtes, nëse nuk jepet vetëm *kompjuter*, – term ky që propozohet të ngrihet në normë – atëherë do të duhej dhënë: *kompjuter, makinë llogaritëse, ordinator*. Në fjalorin në fjalë kjo renditje është e përkundërt: **computer** – *ordinator, pajisje elektronike që shërben për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit, makinë llogaritëse elektronike, kompjuter*. Termi *kompjuter* në këtë fjalor haset vetëm në kontekst të kompjuterizimit: **computerize** – *kompjuterizoj* dhe **computerized** – *i kompjuterizuar; i pajisur me makinë llogaritëse*. Të gjithë termat e tjerë që në bazë kanë fjalën *computer*, përkthehen në shqip duke përkthyer termin **computer** të anglishtes me termin *ordinator* ose/dhe me termin *makinë llogaritëse elektronike*. Kështu kemi, p.sh.: **computer-based**: *i bazuar në përdorimin e ordinatorit; computer code*: *kod ordinatori, kod i makinës llogaritëse; computer-controlled*: *i komanduar me makinë llogaritëse; computer operation*: *operacion ordinatori, operacion i makinës llogaritëse*.

<sup>5</sup> I tillë është edhe *Fjalori i termave themelorë të mekanikës*, i përmendur më lart.

Edhe disa nga termat kyç të elektroteknikës, pra dhe të informatikës [ord. e tek.llog. – sipas autorit], jepen me disa barasvlerës. Kështu, p.sh., për **circuit** kemi: *rrethojë, qark, kontur*; për **amplifier** kemi: *përforcues, zmadhues, rritës, amplifikator*; për **adder** kemi: *pajisje shumatore, qark mbledhës / shumator*, ndërsa për **apply** kemi: *zbatoj, përdor, ushtrij, aplikoj*; *vë, vendos*. Ndërsa për **binary adder** kemi: *aparaturë njezhore dysh, aparat llogaritës binar*; për **binary cell** kemi: *element dyshor, element binar*, për **binary element** kemi: *element me bazë dy, element binar, qelizë dyshore*, e për **binary sistem** kemi: *sistem dyshor, sistem binar, sistem me bazë dy*. Siç shihet, termit **binary** të anglishtes i korrespondojnë katër terma në shqip: *dysh, dyshor, me bazë dysh, binar*.

Nuk ka konsekuencë as në përdorimin e termave në çift; kështu, b. f., kemi, për: **data in** – *informacion i hyrjes, të dhëna hyrëse*, ndërsa për: **data out** – *të dhëna të daljes, informacione të dhëna*. Vetë fjala **data**, si term që përdoret në informatikë, jepet si: *të dhëna, fakte*. Mbase fjala *fakte* nuk shkon me përdorimin e saj në informatikë.

Edhe pse autori thotë se: "kuptimet shumë të përafërta dhe sinonimet ndahen me presje, kuptimet më të largëta me pikëpresje, kurse kuptimet e tjera me pikë dhe renditen duke u paraprirë një numër" dhe se "shpjegimet e ndryshme janë dhënë me germa kursive brenda kllapave" – nuk veprohet kështu gjithmonë. Kështu, p.sh., për fjalën term **cipher** (tek. llog) të anglishtes jepet vetëm: *shifër, zero*, e nuk tregohet se kur duhet përdorur njëra, e kur tjetra. Po ashtu përdorimi emëror dhe ai foljor hasen në një vend, të ndarë vetëm me presje, si p.sh. **clip** – *kapëse* [emër], *mbërthej* [folje]; **code** – *kod shifër* [emër], *kodoj* [folje]<sup>6</sup> etj.

Një fjalor tjetër i kohëve të fundit i cili pretendon se ka edhe terma nga informatika, dhe pikërisht nga *interneti*, është "Fjalori enciklopedik anglisht – italisht – shqip për bankën, biznesin, bursën, ekonominë, ....internetin,...." i Ilir Hotit, Durrës, 2001. Fjalori përmban rreth 40000 terma, fraza, shkurtesa etj.

<sup>6</sup> Shënimet brenda kllapave janë të miat, jo të autorit të Fjalorit.

Nga termat e informatikës që jepen në këtë fjalor po veçojmë, në radhë të parë, termat që lidhen me kompjuterin e që kryesisht janë shqipëruar drejt, si: **computer** – kompjuter; *mjet llogaritës*, **computer console** – panel kompjuteri, **computer integrated manufacturing** – fabrikim i kompjuterizuar, **computer tape** – shirit kompjuteri, **computer trading** – tregtim me kompjuter. Ndërkaq, nuk ka konsekuencë në përdorimin e termit **file**, i cili përkthehet si *dosje*, por dhe si *skedë* e *skedar*: **file transfer protocol** – protokol i transferimit të *skedës*” [metodë e ngarkimit të një *skedari* në internet]. Është i pazakonshëm, ndërkaq, përkthimi i fjalës term **display**, si “*ekranizim*”, – ku termi *ekranizim* përdoret në kuptimin e “shfaqjes pamore të të dhënave, pamjeve, përmbajtjes në ekran”, pra ndryshe nga përdorimi i tij në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe: “bërja e një filmi sipas një romani, tregimi etj”.<sup>7</sup> Hasim një varg fjalësh me emrat **web** e **internet**, si p.sh.: **world wide web** – rrjet i mbarëbotshëm, **web page** – faqe rrjeti, *faqe merimange*, *faqe veb*, *faqe interneti*, **web page address** – adresë e faqes së merimanges; **Internet address** – adresë interneti, **Internet keyed payment** – pagesë e koduar në internet, **internet service provider** – ofruer shërbimi interneti. Ka mjaft terma të ndërtuar me mbiemrin **electronic** (elektronik), si, p.sh.: **electronic mail**, **e-mail**, **e-mail address** – postë elektronike, **electronic payment system** – sistem elektronik pagesash, **electronic point of sale** – pikë shitje elektronike, **electronic wallet** – portofol elektronik, **electronic window** – sportel elektronik, **electronic funds transfer** – transferim elektronik fondesh, **electronic cheque** – çek elektronik. Togfjalëshi **digital signature** përkthehet si: **firmë shifrore**. Për termin **download** kemi: *ngarkim elektronik* [i një *file* në një kompjuter nga burime të ndryshme, p.sh. nga interneti, nga një kompjuter tjetër etj.]<sup>8</sup>, ndërsa për termin **upload** kemi: *ngarkim me program* [i një kompjuteri nëpërmjet një kompjuteri tjetër apo disketave]<sup>9</sup>. Hasim edhe **on line** – në linjë dhe **link** – lidhje. Termi **personal computer** përkthehet si:

<sup>7</sup> Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë 2002

<sup>8</sup> Shpjegimi brenda kllapave është i autorit të “Fjalorit”.

<sup>9</sup> Informacionet shitesë brenda kllapave për **download** dhe **upload** janë të autorit të “Fjalorit”.

*komputer stacionar*, ndërsa termi **laptop** si: *komputer lëvizës*.<sup>10</sup>

Që një pjesë e fjalorit të informatikës është bërë pjesë përbërëse e leksikut të përgjithshëm, dëshmon edhe “Fjalori anglisht–shqip” i Ramazan Hysës, i botuar në Tiranë më 1998.

Pa hyrë në hollësi, meqë ky fjalor nuk është objekt vështrimi i këtij punimi, po japim disa shembuj të paraqitjes së termave nga informatika në këtë fjalor. Në të hasim mjaft terma të informatikës, duke filluar nga termi **computer**, i cili së bashku me fjalët e prejardhura nga ai ose të ndërtuara me të jep një çerdhe prej 15 fjalësh terma:

**computer** – makinë llogaritëse; *komputer, ordinator; computerate* – shih **computer literate**; **computer-aided/assisted design** – vizatim teknik me kompjuter; **computer dating** – takim (dy personash) me ndihmën e sistemit informatik telefonik; **computerese** – gj. fol. zhargon i (gjuhë e) informatikës, **computer game** – lojë elektronike, lojë me kompjuter, **computerist** – amer. informatikan; **computerization** – 1. trajtim elektronik, kompjuterizim; automatizim; 2. hedhje (të dhënash etj.) në kompjuter; **computerize** – 1. informatizoj, kompjuterizoj; përpunoj në kompjuter. 2. hedh në kompjuter; **computer language** – gjuhë programimi; **computer literate** – që ka njohuri në informatikë, që njeh kompjuterin; **computer operator** – kompjuterist, person që punon në/me kompjuter; **computer programmer** (kmp.) – programist; **computer science** – informatikë; **computer studies** – informatikë dhe, në fund: **computing (computer science)** – informatikë.

Siç mund të vërehet, edhe te ky fjalor, për fjalën term **computer** të anglishtes kemi po të njëjtit barasvlerës si te fjalori i Tomçinit, vetëm me renditje tjetër.

Është për t'u theksuar, ndoshta, se termi *informatikë*<sup>11</sup> i shqipes i korrespondon tri termave të anglishtes, që në fakt janë sinonime:

<sup>10</sup> Jepen në kuadër të shpjegimit të termit *internet*

<sup>11</sup> Krahas termit *informatikë* në përdorim, sidomos në Kosovë, është edhe termi *kompjuterikë*. Kjo bën që ngandonjëherë të hasen edhe struktura tautologjike, si: "drejtimi (dega) kompjuterikë me informatikë" apo "shkencat kompjuterike me informatikë".

**computer science, computer studies** dhe **computing**<sup>12</sup>, por dhe: **information technology** – teknologji e informacionit, më drejt.

Në Fjalorin e R. Hysës hasim edhe terma të tjerë nga informatika [kmp.], si: **file** – fishë, skedë, dosje; **folder** – dosje; **hardware** – pjesë mekanike/elektronike, material strukturor (i kompjuterit); **download** – transferoj, hedh (në kompjuter) [pra, si: **computerize!**], **update** – freskoj, azhurnoj (të dhënat); **font** – komplet germash, lloj germash; **character** – gërmë, shkronjë; **hacker** – pirat informatik, **byte** – bajt (varg 6 ose 8 njësisish dyjore – bitësh) [nuk e ka bit, edhe pse bajtin e jep si: tetëbitësh]; **menu** – meny; **monitor** – monitor; **mouse** – mi; **printer** – printer, pajisje shtypi, nxjerr një kopje të shtypur; **processor** – procesor, përpunues informacioni; **scanner** – skaner, analizator, **terminal** – terminal, element fundor.

Është për t'u vërejtur, ndoshta, se i mungon termi **internet**.

Siç e kam thënë (dhe arsyetuar) më parë në një artikull në “Koha ditore”<sup>13</sup>, mendoj se për termat e informatikës **upload** dhe **download** të anglishtes më të përshtatshëm do të ishin barasvlerësit shqip *mbart* dhe *zhbart* (me rrjedhojat e tyre), sesa barasvlerësit *ngarkoj* dhe *shkarkojë* (me rrjedhojat e tyre). Po ashtu, mendoj se për çiftin: **file** – **folder**, të anglishtes, duhet parapëlqyer çifti *skedar* – *dosje* i shqipes. Termi **update** duhet përkthyer si: *përditësoj*. Nga *përditësoj* kemi *përditësim* dhe *përditësuar*.

Dhe në fund, disa fjalë edhe për Fjalorin e shqipes së sotme<sup>14</sup>. Edhe pse, si thuhet me të drejtë<sup>15</sup>, ky fjalor nuk është as fjalor terminologjik, e as fjalor profesionalizmash, mendoj se ndër 35000

<sup>12</sup> Në anglishte ekziston edhe termi *informatics*, i përdorur për herë të parë më 1966, si përkthim i termit të rusishtes *informatika*. Vetë termi *informatikë* rrjedh nga frëngjishtja *informatique*, që paraqet një fjalë të përngjitur nga *information* dhe *automatique*.

<sup>13</sup> N. Caka, “Shqipërimi i disa termave të informatikës”, *Koha Ditore*, Prishtinë, 18 shtator 2004.

<sup>14</sup> Botim i dytë i ripunuar, Tiranë, 2002.

<sup>15</sup> Sh. Islamaj, “Leksikografia shqiptare në rrethanat e reja”, Prishtinë, 2003.



fjalët e tij, që përfshijnë edhe terma të ndryshëm, nga 70 fusha të ndryshme, megjithatë, kanë mundur të gjejnë vend edhe disa terma të informatikës dhe vetë informatika si fushë e shkencës dhe e teknikës. Në këtë fjalor, të punuar në kompjuter<sup>16</sup>, kanë mundur të gjejnë vend fjalët terma që tashmë janë bërë pjesë përbërëse e shqipes së sotme, të folur e të shkruar, si: *disketë; formatoj e formatim; internet e intranet; klikoj e klikim; kompjuter, kompjuterik e kompjuterizoj; kursor; mikroprocesor e mikrokompjuter; printer, printoj, printim e i printuar; monitor, monitoroj e monitorim, laser<sup>17</sup> e laserik (p.sh. printer laserik); terminal; skaner, skanoj e skanim e ndonjë tjetër. Po ashtu, shpjegimi i disa fjalëve të dhëna në këtë fjalor do të mund të plotësohej edhe me kuptimet që kanë në fushën e informatikës. Këtu, para se gjithash, mendoj në fjalët që i përdor secili përdorues i kompjuterit, si: *disk (disk magnetik, disk optik), dritare, dosje, ikonë, skedar, kujtesë<sup>18</sup>, meny, mi, ruaj, virus, tast, tastierë* etj. Do të mund të futeshin edhe fjalët-terma të informatikës, po ashtu të përdorimit të përgjithshëm, të krijuara brendapërbrenda shqipes, si: *faqeshenjues (për: bookmark të anglishtes), fjalëkalim (për: password), fletëmbajtëse (për: clipboard), shkurtore (për: shortcut), regjistresë (për: record)<sup>19</sup>* e ndonjë tjetër. Kjo do të ndihmonte njësimin e termave të informatikës dhe do të përshpejtonte procesin e normëzimit dhe të standardizimit të tyre.*

Standardizimi i terminologjisë së informatikës mund të arrihet vetëm me një bashkëpunim të ngushtë të gjuhëtarëve e të specialistëve të informatikës. Pa këtë bashkëpunim nuk mund të ketë normëzim të kësaj terminologjie. Jetësimin e kësaj terminologjie do ta përshpejtonte futja e termave të normëzuar në tekstet shkollore të të gjitha niveleve të shkollës shqipe.

<sup>16</sup> Kjo edhe thuhet në fillim të këtij fjalori: “*përpunimi kompjuterik*”.

<sup>17</sup> Për mendimin se duhet thënë dhe shkruar *laser* (nga: *light amplification by stimulated emission of radiation*) në vend të *lazër* shih: N. Caka, "Standardizimi i terminologjisë së informatikës", Koha ditore, 4 dhjetor 2004.

<sup>18</sup> Nga termi *kujtesë* kemi edhe termat: *kujtesoj* (fut në kujtesë), *kujtesim* (futje në kujtesë) dhe *i kujtesuar* (i memoruar). Shih për këtë: "Për pastërtinë e gjuhës shqipe – Fjalor", Tiranë, 1998.

<sup>19</sup> N. Caka "Shqipërimi i disa termave të informatikës", Koha ditore, 18 shtator 2004.

Po e përfundoj këtë punim (kumtesë) me konstatimin se sa më parë të bëhet shqipërimi i termave që mund të shqipërohen – pa kaluar në purizëm dhe pa rrezikuar përdorimin normal të teknologjisë së informacionit, e duke pasur gjithnjë parasysh se shqipërimi i termave bëhet për të lehtësuar të kuptuarit e nocioneve dhe të koncepteve të një fushe, në këtë rast të fushës së teknologjisë së informacionit, përkatësisht të informatikës – aq më lehtë do të pranohen këta. Sa më parë që të bëhet kjo, aq më parë do të mësohemi me termat e rinj dhe nuk do të na ndodhë që të mos jemi të gatshëm të pranojmë fjalën-term *ndemje* për *tension*, *nxënësi* për *kapacitet*, *denduri* (më drejt *shpeshiti*) për *frekuencë*, apo madje edhe *gjasë* për *probalitet*, siç i kemi pranuar fare mirë termat *rrymë* (elektrike) për *korrent* dhe *trusni* për *presion*, dhe nuk do të mëdysëshim a të themi *përforcues* apo *amplifikator*, *vatër* apo *fokus*, *përthithje* apo *absorbim*, siç nuk na shkon mendja që për *dritare* të themi *penxhere*, *prozore* apo *uindow*<sup>20</sup>.

## LITERATURA

1. A. B. Tomçini, *Fjalor anglisht–shqip i radioelektronikës*, Tiranë, 2004.
2. B. Ranilović, *Hrvatska standardizacija računalne terminologije*, Jezično savetovanje za Nastavnike informatike: *Hrvatsko računalno nazivlje*, Zagreb, 2004.
3. C. Gomez, M. Pinto, *La normalization au service du traducteur*, “Meta”, XLVI, 3, 2001.
4. D. Brozović, *Medjunarodna anglojezična i hrvatska stručna terminologija*, Jezično savetovanje za Nastavnike informatike: *Hrvatsko računalno nazivlje*, Zagreb, 2004.
5. *Fjalor i shqipes së sotme*, botim i dytë i ripunuar, Tiranë, 2002.
6. *Fjalor i termave themelorë të mekanikës*, Tiranë, 2002.
7. G. Adamo, *La terminologia tecnico-scientifica in lingua italiana. Alcune osservazioni sulla terminologia dell' informatica*, Seminario “Réflexions méthodologiques sur le travail en terminologie et en

<sup>20</sup> Dy fjalët e para (*penxhere* e *prozor*) – turqizëm e sllavizëm, të përdurura jo edhe aq moti në disa vise shqiptare; fjala e tretë (*uindow*) – fjalë-term i informatikës (i kompjuterit) në gjuhën angleze.

terminotique dans le langues latines", *Journées Realiter*, Nizza, Università Sophia-Antipolis, 1-2 luglio 1996.

(<http://www.realiter.net/nice/adamo.htm>)

8. G. Roncaglia, *Italiano e terminologia informatica*, "Il toposcannato", 2004.

[http://www.marzweb.com/testi/seggi/italiano\\_e\\_terminologia\\_informatica.htm](http://www.marzweb.com/testi/seggi/italiano_e_terminologia_informatica.htm)

9. H. Pasho, *Shqipja terminologjike në vitin 2000*, "Seminari XIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe", Prishtinë, 2001.

10. H. Shehu, *Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe*, "Seminari XIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqipe", Prishtinë, 2001.

11. I. Hoti, *Fjalori enciklopedik anglisht – italisht – shqip për bankën, biznesin, bursën, ekonominë, ...internetin,...*, Durrës, 2001.

12. L. Depecker, *Terminologie et standardisation*, "Jornada popullatina de terminologia" – Perspectives i camps d'aplicacio, 1995.

13. M. Kiš, J. Buljan, S. Vuković, O. Anić, *Englesko-hrvatski informatički rječnik, s računalnim nazivljem*, "Školska knjiga", Zagreb, 1993.

14. M. Locati, *Lingua inglese e comunicazione nell'era del PC e di internet: Un'analisi sociolinguistica*, 1999,

<http://www.tiscali.it/WebAcademy/Maddalena/cap5.htm>

15. N. Caka, *Shqipërimi i disa termave të informatikës*, "Koha ditore" (Koha për Kulturë), Prishtinë, 18 shtator 2004.

16. N. Caka, *Standardizimi i terminologjisë së informatikës*, "Koha ditore" (Koha për Kulturë), Prishtinë, 4 dhjetor 2004.

17. *Për pastërtinë e gjuhës shqipe* – Fjalor, Tiranë, 1998.

18. P. N. Dohler, *Standardizing the terminology* "ATA Chronicle", May 1995.

19. R. Hysa *Fjalor anglisht–shqip*, Tiranë, 1998.

20. Sh. Islamaj, *Leksikografia shqiptare në rrethanat e reja*, "50-vjetori i Institutit Albanogjik", Prishtinë, 2003.

21. V. Batagelj, *Razvoj slovenskega računalniškega izrazja – osebni pregled*, 2000. <http://www.vlado.fmf.uni-lj.si/dic/doc/dsi01.htm>